

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Drain GEO S

FLETA SINTETIKE DRENAZHIMI ME GJEOTEKSTIL TË NGULITUR

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Drain GEO S është fletë me bazë HDPE (polietilen me dendësi të lartë) dhe gjeotekstil të ngulitur, e konfiguruar në mënyrë të përshtatshme për lehtësimin e drenazhimit të ujërave nëntokësorë.

PËRDORIMET

Sika® Drain GEO S përdoret si një fletë mbrojtëse për sistemet e hidroizolimit dhe për lehtësimin e drenazhimit të ujit në projekte nëntokësore si kopshtet, muret mbajtës, shtylla urash, etj. Përdoret gjithashtu si një fletë mbrojtëse në tunele, çati / tarraca të gjelbra, vazot e luleve të vendosura përpara dritareve, etj.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Rezistencë shumë e lartë kundër sulmeve kimike
- Rezistencë kundër depërtimit të rrënjëve
- Zgjidhje shumë ekonomike
- Aplikim i lehtë
- Rezistencë mekanike e lartë

Sika® Drain GEO S krijon një hapësirë midis elementit të ndërtimit dhe mbushjes, duke lehtësuar kështu qarkullimin e ajrit, ujit dhe avullit dhe përmirëson funksionimin e sigurt të sistemit hidroizolues. Për shkak të rezistencës së saj të jashtëzakonshme, mbron sistemin e hidroizolimit nga sforcimi mekanik dhe dëmtimet gjatë procesit të mbushjes.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Fletë me formë prej polietileni në dendësi të lartë (HDPE) dhe gjeotekstil të integruar (PP).	
Ambalazhi	Ruloni: 2.40 m (gjerësi) x 20.00 m (gjatësi) Pesha: ~ 600 gr/m ²	
Paraqitja / Ngjyra	Fletë në rulona Sipërfaqja: E sheshtë me dalje në formë konike dhe gjeotekstil me të ngulitur. Ngjyra: Kafe (fleta) – I bardhë (gjeotekstili)	
Jetëgjatësia	Produkti nuk skadon nëse magazinohet në kushtet e duhura.	
Kushtet e magazinimit	Rulonat duhet të ruhen në kushte të thata dhe në pozicion vertikal ose horizontal, të mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor, shiu dhe dëbora.	
Trashësia	Me ngarkesë 2kPa 7.5mm (±1)	(EN ISO 9863-1)
Njësia e peshës	Sistem i përbërë 600 ±30 gr/ m ²	Gjeotekstil 100 gr/ m ² (±10) (EN ISO 9864)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj shpimit statik	Testi CBR 1150 N (-175)	(EN ISO 12236)
Rezistenca ndaj shpimit dinamik	38 mm (+8)	(EN ISO 13433)
Rezistenca ndaj ngjeshjes	200 KN/m ² (±30)	
Rezistenca ndaj tërheqjes	Sistem i përbërë 10 KN/m (±2)	Gjeotekstil 7.5 KN/m (±2) (EN ISO 10319)
Zgjatimi	Sistem i përbërë 30% (±5)	Gjeotekstil > 45% (EN ISO 10319)
Përshkueshmëria e ujit	110 mm/s (-35)	(EN ISO 11058)
Përmasa e hapjes	100 mikron (±30)	(EN ISO 12956)
Aftësia për rrjedhjen e drenazimit	1.9 lt/(m.s) ± 0.2 [MD (20kPa, S/R, i=1)	(EN ISO 12958)

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit

Produkte ndihmëse:

- Sika® Drain Profile – pjesë e posaçme për fundet me përmasa 2.00 m (gjatësi) x 7 cm (gjerësi), prej polietileni me dendësi të lartë (HDPE) për mbrojtjen e prerjeve
- Sika® Drain Plugs & Nails – gjilpëra të posaçme me tapa plastike për mbërthimin e pjesëve dhe aksesorëve

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër, e thatë dhe pa kontaminues të sipërfaqes. Përpara se të vendosni fletët Sika® Drain GEO S, sistemi i përzgjedhur i hidroizolimit duhet të jetë aplikuar dhe të ketë përfunduar aplikimi. Në rast se sistemi përmban një produkt të aplikuar mbi sipërfaqe, ky produkt duhet të jetë maturuar plotësisht. Gjithashtu, duhet të sigurohet një rrugë daljeje për ujin e drenazuar, ose në nëntokë ose në rast të rrjedhjes së madhe të tubave konvencionalë të drenazimit (tuba drenazimi të perforuar) dhe aggregate të kokërrtrasha, të aplikuar lirshëm.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Fletët Sika® Drain GEO S mund të vendosen me zgjerimet në formë konike përballë nënshtresës që do të mbrohet. Fiksimi i fletëve bëhet me gozhdë çeliku pothuajse çdo 25 cm, në pikën më të lartë (kurorëzimin) të elementit të konstruksionit. Mbivendosjet duhen bërë me kujdes, që të parandalohet depërtimi i dheut midis fletëve. Gjerësia minimale e rekomanduar e mbivendosjes është 20 cm.

KUFIZIME

Pas instalimit dhe montimit të fletëve mbi sipërfaqe, fiksoni skajin e sipërm të Sika® Drain GEO S me pjesën e posaçme Sika® Drain Profile. Ose, për të parandaluar depërtimin e dheut, izoloni hapësirën e brendshme midis konfiguracioneve të sistemit dhe sistemeve hidroizolues me izolues (p.sh. Sikaflex® Pro-3).

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Drain GEO S

Shkurt 2019, Botimi 01.01

020704990010000050

SikaDrainGEOS-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf